

VENDIM
Nr.636, datë 20.9.2006

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE “UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Universiteti European i Tiranës”, në emër të shoqërisë “UET”, sh.p.k. e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.

2. “Universiteti European i Tiranës” përbëhet nga këto dy fakultete:

a) Fakulteti i Shkencave Sociale, me degët e mëposhtme:

- Gazetari (3 vite);
- Komunikim-marrëdhënie publike(3 vite);
- Shkenca politike (3 vite);
- Marrëdhënie ndërkombëtare(3 vite).

b) Fakulteti Juridik me degën:

- Jurist i përgjithshëm.

Kjo degë profilizohet në juridik biznes, juridik e drejta publike e kushtetuese dhe juridik e drejta, europiane dhe ndërkombëtare.

3.“Universiteti European i Tiranës” do të ofrojë studime universitare të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 vite akademike. Në mbarim të studimeve ky universitet do të japë diplomë universitare “Bachelor” në titujt e mëposhtëm:

- Gazetari;
- Komunikim - marrëdhënie publike;
- Shkenca politike;
- Marrëdhënie ndërkombëtare;

- Jurist i përgjithshëm ose i shoqëruar me profilizimin përkatës: juridik biznes, juridik e drejta publike e kushtetuese dhe juridik e drejta, europiane dhe ndërkombëtare.

4.“Universiteti European i Tiranës” do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.

5.Ministria e Arsimit dhe Shkencës të verifikojë objektin, jo më vonë se tri javë para fillimit të procesit mësimor. Çdo ndryshim në përcaktimin e vendndodhjes, të stafit pedagogjik, planeve dhe programeve, si dhe të elementeve të tjera, të miratuara, të bëhet me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe akreditimit të kurseve të studimit, si dhe të zbatimit të ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha